

Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl.-Kzz. Nr. 50/2009
16 nëntor 2009
Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e formuar në pajtim me nenin 26, paragrafin (3) të Kodit Penal të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi Kompetencat) të përbërë nga:

- Guy Van Craen, Gjyqtar i EULEX-it, si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues,
- Emilio Gatti, Gjyqtar i EULEX-it,
- Miftar Jasiqi, Gjyqtar i Gjykatës Supreme,
- Zait Xhemajli, Gjyqtar i Gjykatës Supreme dhe
- Avdi Dinaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, si anëtarë të kolegjit;

Në lëndën penale kundër [redacted] et alia, i dënuar për veprat penale Krim i organizuar, në shkelje të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/22, neni 2.4, lidhur me nenin 245 (2) të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), Shitje dhe prodhimi i paautorizuar i narkotikëve në bashkëpunim, në shkelje të neneve 22 dhe 245, paragrafit (2) të Kp RSFJ-së, dhe Mbajtje e paautorizuar e armës, në shkelje të Rregullores së UNMIK-ut 2001/7, neni 8.2;

Duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të të pandehurit [redacted] [redacted] paraqitur përmes Avokatit të tij mbrojtës [redacted] kundër aktgjyqimit të Gjykatës Supreme Ap.Kz. Nr. 355/2006, të datës 11 nëntor 2008, e cila ka pranuar pjesërisht ankesën e tij kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.Nr. 481/2004, të datës 18 nëntor 2005;

Pas shqyrtimit të procesverbalit, kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të të pandehurit, argumentet e Prokurorit Publik, dhe pas analizimit të ligjeve relevante;

Pas këshillimit të mbajtur më 16 nëntor 2009;

Sipas nenit 456 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë

AKTGJYKIM

Q.S.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit [REDAKTUAR] e paraqitur përmes Avokatit të tij mbrojtës [REDAKTUAR] kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap.-Kz. Nr. 355/2006, të datës 11 nëntor 2008, **REFUZOHET si e pabazuar.**

ARSYETIMI

1. Procedura:

- Kërkesa me kohë e të pandehurit [REDAKTUAR] është paraqitur në mënyrë të rregullt nga avokati i tij [REDAKTUAR] kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 18 nëntor 2005, dhe vendimit mbi ankesë të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 11 nëntor 2008. Me këtë kërkesë mbrojtja propozon anulimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të dytë dhe ta kthejë lëndën në rigjykim kështu që [REDAKTUAR] shqiptohet një dënim i vetëm për veprën penale "krim i organizuar" sipas nenit 2.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/22.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në esencë pretendon:

- Se vendimi i shkallës së parë dhe të dytë ka dështuar të paraqes dëshmi të mjaftueshme dhe të pranueshme sa i përket veprave penale dhe dënimit të shqiptuar;
- Se ligji penal është shkelur nga gjykata e shkallës së dytë sepse ka përsëritur shkeljet e njëjta sikurse juridiksioni i shkallës së parë;
- Se Rregullorja e UNMIK-ut 2002/22, neni 2.4 është shkelur sepse nuk është shqiptuar një dënim për krimin "krim i organizuar" nga Gjykata Supreme mirëpo në vend të kësaj dhe gabimisht, një dënim i ndarë për secilën pikë të veprave penale të lidhura me drogën, vepra mbajtje e paautorizuar e armës dhe për pikën e "krimit të organizuar", të gjitha rezultojnë në dënim unik.

Kërkesa argumenton se "shkurtimisht"se nuk ka veprë penale të vetme të krimit të organizuar sipas nenit 2.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/22, respektivisht 274 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së). Dispozita e nenit 2.4 e Rregullores së lartpërmendur, respektivisht neni 274 të KPK në termin e ligjit penal quhet dispozitë ndëshkuese [....].

3. Gjykata Supreme, në kolegjin i cili merret me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë:

- Duke marrë parasysh argumentimet sa i përket juridiksionit "ka dështuar të paraqes dëshmi të mjaftueshme dhe të pranueshme", rikujton nenin 451 (2) të KPPK-së me të cilin kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi baza të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Deri më tani kërkesa e mbrojtjes i referohet elementeve dhe dëshmimeve mbi të cilat ky vlerësim faktik i gjykatës është bazuar, kjo kërkesë nuk mund të konsiderohet si e pranueshme. Për më tepër, brenda kornizës së kufijve të nenit 455 të KPPK-së, mbrojtja nuk e specifikon me cilin, edhe pse kryesisht dhe në mënyrë precize e motivuar, vendimet

- gjqësore të juridiksionit të shkallës së parë dhe të dytë, kanë shkelur ligjin. Duhet vërejtur se vendimi i shkallës së dytë ka liruar të pandehurin nga pikat A1 dhe A2. Përfundimisht gjykata në analizat e saj ligjore *ex officio* nuk ka zbuluar ndonjë paligjshmëri apo kundërshtim në motivimin e vendimeve të kundërshtuara sa i përket arsytimit i cili shpie deri te dënimi dhe/ose motivimit mbi dënimin.
- Kjo gjykatë nënvizon se të drejtat e mbrojtjes janë garantuar me të dy juridiksionet dhe në veçanti sa i përket nenit 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (KEDNj-së), Kushtetutës dhe KPPK-së. Kjo gjykatë gjithashtu ka vërejtur se i pandehuri është dënuar për akuzat, saktësisht të kualifikuara, të cilat janë përfshirë në aktakuzë, të datës 20 shtator 2004, aktakuzën e ndryshuar dhe vendimin e konfirmimit të datës 18 dhjetor 2004.
 - Duke marrë parasysh argumentimin sa i përket dënimin joligjor deri më tani juridiksioni i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të shqiptojë vetëm një dënim në vend të dënimit unik, gjykata nënvizon:
 - a) Se *ratio legis* (shih hyrjen para nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/22) dhe tekstin e rregullores 2001/22, e aplikueshme në këtë lëndë, dhe i qartë nga definimi “krim i organizuar” si krim autonom dhe në këtë lëndë si krim i ndarë. Në të vërtetë, neni 2.1 i Rregullores 2001/22 përcakton qartë: “dënimet [...] për kryerjen e krimit të organizuar duhet të SHTOHEN dënimin të shqiptuar për kryerjen e “krimit të rëndë” brenda kufijve të përcaktuar në nenin 48 të Kodit Penal të aplikueshëm, *theksimet e shtuara*. Në këtë kuptim krimi i “krimit të organizuar” ka objektiven dhe substancën morale e cila ndryshon nga “krimi i rëndë” i kryer për të cilin grupi i strukturuar është konstituuar “në mënyrë që të përfitojnë, drejtpërdrejtë apo indirekt dobi financiare apo materiale” (*conferatur* neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/22).
In casu “krimet e rënda” janë krime të lidhura me drogën apo transferim ose shitjen (në data dhe vende të ndryshme dhe përbëjnë krime të ndara siç është cekur drejtësisht nga Gjykata e Apelit dhe pranuar nga Gjykata Supreme) siç është specifikuar në akuzat e konfirmuara në vendimin e Gjykatës së Apelit: A3, A4, A5.
 - b) Se vepra e “krimit të organizuar” është në përputhje me definimin e veprës penale, siç është përcaktuar me nenin 8 të Kodit Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ): “një akt kriminal është akt i rrezikshëm për shoqërinë i cili me ligj është përcaktuar si vepër penale, karakteristikat e të cilit janë përcaktuar me ligj” dhe më saktësisht i përcaktuar në nenin 6 të KPK-së, respektivisht: “akt i paligjshëm i cili me ligj përcaktohet si vepër penale, karakteristikat e të cilit përcaktohen me ligj dhe për të cilin sanksionimi penal [...] përshkruhet me ligj”. Rregullorja 2001/22 përshkruan saktësisht aktin kriminal, karakteristikat e tij dhe elementet substanciale të tij. Për më tepër, Rregullorja e përmendur gjithashtu parasheh forma të ndryshme të pjesëmarrjes në kryerjen e këtij krimi dhe sanksionimet që duhet të shqiptohen.

c) Se në kundërshtim me argumentet e mbrojtjes, dispozitat e përshkruara në Rregulloren 2001/22 / neni 274 i KPK-së për veprën penale krim i organizuar nuk janë vetëm “dispozita ndëshkuese” mirëpo normativa të aplikueshme sanksionuese të aplikueshme për kryerjen e veprës autonome krim i organizuar.

Prandaj, ky akt i paligjshëm i krimit të organizuar, NUK duhet të definohet si një “krim i përgjithshëm” që absorbon “krimin e rëndë” (*in casu* akuzat A3, A4, A5), as si rrethanë rënduese e as si formë e bashkëpunimit apo ndihmës në krim.

Q.S.

4. Përfundimi:

Gjykata Supreme përmes procedurës së Mbrojtjes së Ligjshmërisë duke shqyrtuar vendimet e juridiksionit siç është kërkuar nga mbrojtësi i [REDAKTUAR] dhe brena kufijve të kompetencave të saj (*conferatur* nenet 451-455 të KPPK-së) konsideron se arsyetimi i cili shpie në dënimin e të pandehurit dhe në sanksionimin e shqiptuar, dënimin dhe sanksionimin e shqiptuar (dënimi unik), janë në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Kërkesa e mbrojtjes për mbrojtjen e ligjshmërisë duhet të, për arsyet e lartpërmendura, REFUZOHET pasi që është e pabazuar (*conferatur* neni 456 të KPPK-së). “Shkelja e nenit 403, paragrafit 1, pikave 10/12, paragrafit 2, pikës 2, neni 404, pikës 4 të KPPK-së” e pretenduar (e përshkruar në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) nga të dy juridiksionet nuk është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl.-Kzz. Nr. 50/2009
16 nëntor 2009
Prishtinë

Anëtarët e kolegjit:

Emilio Gatti
Gjyqtar i EULEX-it

Miftar Jasiqi
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Zait Xhemajli
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Avdi Dinaj
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtëse:

Guy Van Craen
Gjyqtar i EULEX-it

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Judit Eva Tatraj
Zyrtare Ligjore e EULEX-it

Aktgjykim
Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl.-Kzz. Nr. 50/2009
[REDAKTUAR] et alia

SAKTËSINË E KOPJES E VERTETËSON
ТАЧНОСТ ОТПРАВКА ПОТВЕРЖДАЕТ

Punëtor i autorizuar
Зyртовaннaя